



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT
I
AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 835/2016

Bexhet Reka

Drejtuar:

Z. Albin Kurti, kryeministër
Qeveria e Republikës së Kosovës

Z. Liburn Aliu, ministër
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Kopje:

Z. Mentor Hyseni, kryesues
Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Z. Sahit Sylejmani, ushtrues detyre i gjyqtarit mbikëqyrës
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

Z. Habit Hajredini, drejtor
Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, 21 shtator 2023

I. QËLLIMI I RAPORTIT

1. Qëllimi i këtij raporti është që ta tërheqë vëmendjen e autoriteteve lidhur me të drejtën e pronës së ish-punonjësve të ish-Ndërmarrjes Shoqërore - Kooperativa Bujqësore “Liria” Bardhosh (N.Sh. “Liria”), një pjesë e së cilës është shpronësuar për interes publik në vitin 2012, për çfarë ata akoma nuk kanë marrë kompensim; t’i konstatojë shkeljet e të drejtave të njeriut si dhe t’u rekomandojë autoriteteve ndërmarrjen e veprimeve me qëllim të rivendosjes të së drejtës së shkelur.

II. BAZA LIGJORE DHE KOMPETENCA E AVOKATIT TË POPULLIT

2. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
3. Gjithashtu Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, i ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - *“Të bëjë hetime [...] me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 4);*
 - *publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë (neni 16, paragrafi 15);*
 - *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, pika 2);*
 - *të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit (neni 18, paragrafi 1, pika 5);*
 - *t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta (neni 18, paragrafi 1, pika 6);*
 - *Avokati i Popullit mund t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës (neni 18, paragrafi 3).*

III. RRETHANAT E RASTIT

4. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 17 nëntor 2016 kishte pranuar ankesë nga z. Behxhet Reka, parashtruar kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), lidhur më shpronësimin e pronave të paluajtshme të ish-Ndërmarrjes Shoqërore - Kooperativa Bujqësore “Liria” Bardhosh (N.Sh. “Liria”), me qëllim të ndërtimit të autostradës Vermicë – Merdare.
5. Ankesa e paraqitur ka të bëjë me çështjen e kompensimit nga shpronësimi i tokave të N.Sh. “Liria”, ndërsa ankuesi është ish-punonjës i kësaj ndërmarrjeje, i cili pretendon se ai, sikur

edhe ish-kolegët e tij, nuk kishin marrë kompensimin për pronat e shpronësuara me qëllim të ndërtimit të autostradës Vermicë – Merdare.

6. Qeveria e Republikës së Kosovës, më 12 nëntor 2012, kishte marrë Vendim përfundimtar Nr.03/100, sipas të cilit ishin aprovuar shpronësimet dhe vlerësimet në interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe të zotëruesve të interesit, të cilat prekeshin nga ndërtimi i autostradës Vermicë – Merdare, Sektori 9, zonat kadastrare Mazgit dhe Llazarevë të komunës së Obiliqit dhe zonat kadastrare Bërnice e Poshtme, Bardhosh dhe Trudë të komunës së Prishtinës.
7. Qeveria e Republikës së Kosovës, më 16 janar 2013, kishte marrë vendimin përfundimtar, sipas të cilit ishin aprovuar shpronësimet dhe vlerësimet me interes publik të pronave të paluajtshme dhe të zotëruesve të interesit, të cilat prekeshin nga ndërtimi i autostradës Vermicë – Merdare, Sektori 8, zonat kadastrare Prishtinë dhe Shkabaj, komuna e Prishtinës, zonat kadastrare Obiliq dhe Kryshevc, komuna e Obiliqit, zona kadastrare e Fushë Kosovës dhe zonat kadastrare Uglar, komuna e Graçanicës.
8. Qeveria e Republikës së Kosovës, më 5 maj 2013, kishte marrë Vendimin përfundimtar Nr.12/133, sipas të cilit kishte konstatuar se procesi i shpronësimit ishte zgjeruar duke përfshirë në vijim sipërfaqe të caktuara shtesë, të ngastrave kadastrare të cilat tanimë ishin përfshirë në shpronësim në vendimin paraparak.
9. Vendimet për shpronësim nga ana e qeverisë, në mesin e subjekteve të tjera, përfshijnë edhe pasuritë e paluajtshme të N.Sh. “Liria”, e cila sipas Ligjit 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), bie nën juridiksionin administrativ të kësaj agjencie.
10. Avokati i Popullit, më 6 mars 2018, ia kishte dërguar një shkresë drejtorit menaxhues të AKP-së, për të kërkuar informata lidhur me pretendimet e ankuesit, të cilat i kishte mbështetur në kërkesën që AKP-ja ia kishte parashtruar, më 2 maj 2014, Departamentit për Shpronësim i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), për transferimin në llogarinë e N.Sh. “Liria” të mjeteve të kompensimit të pasurisë së shpronësuar. AKP-ja, në përgjigjen e saj të datës 6 korrik 2018, kishte konfirmuar dërgimin e kërkesës në Departamentin për Shpronësim i MMPH-së dhe kishte theksuar se deri më datën 3 korrik 2018, nga MMPH-ja nuk ishte realizuar asnjë transferim i fondeve që kishin të bënin me shpronësimin e aseteve të N.Sh. “Liria”.
11. Avokati i Popullit, më 2 gusht 2018, ia kishte dërguar një shkresë kryeministrit të Republikës së Kosovës për ta ngritur çështjen e moskompensimit për ish-punonjësit e N.Sh. “Liria”, nga shpronësimi i pronave të ndërmarrjes. Ndërsa, më 8 gusht 2018, Avokati i Popullit kishte marrë përgjigje nga Departamenti i Shpronësimit i MMPH-së, ku thuhej se ata e kishin pranuar dhe shqyrtuar kërkesën për transferim në llogarinë rrjedhëse të N.Sh. “Liria” të mjeteve financiare të pasurisë së shpronësuar dhe se pas verifikimit të dokumentacionit e kishin njoftuar AKP-në se parcelat: nr. 308-0, 304-2, 383-0, 384-0, 382-0, 381-5, 386-3, 386-4, të zonës kadastrare Bardhosh, ishin kompensuar sipas Vendimit përfundimtar Nr.03/100, datë 12 nëntor 2014, dhe sipas dokumentacionit pronësor-juridik.
12. Avokati i Popullit, më 28 shtator 2018, ia kishte drejtuar një shkresë drejtorit menaxhues të AKP-së për ta njoftuar me përgjigjen e Departamentit të Shpronësimit të MMPH-së dhe pohimet se pronat në zonën kadastrare Bardhosh ishin kompensuar sipas Vendimit përfundimtar Nr.03/100, datë 12 nëntor 2014, dhe sipas dokumentacionit pronësor-juridik.

Më 10 tetor 2018, Avokati i Popullit kishte marrë përgjigje nga drejtori menaxhues i AKP-së, sipas të cilit, Departamenti për Financa dhe Buxhet i AKP-së dhe Autoriteti i Likuidimit, deri më datën 3 tetor 2018, nuk kishte realizuar asnjë transferim të fondeve që kishte të bënte me shpronësimin e aseteve të N.Sh. "Liria".

13. Avokati i Popullit kishte kontaktuar me ankuesin, i cili kishte sqaruar se ankesën të cilën ai e kishte paraqitur te Avokati i Popullit kishte të bënte me Vendimin përfundimtar 12/133, datë 5 qershor 2013, dhe se ankesa e tij, si ish-punonjës i N.Sh. "Liria", kishte të bënte me zonat kadastrorë: Bërnice e Poshtme, parcelat: 1585-0 (2); 1596-0 (2) dhe 1595-0 (2); Bardhosh, parcelat: 87-2 (2), 114-1 (2), 107-4 (2), 382-0 (2); dhe Trudë, parcela: 535-0 (2), që janë pronë e kësaj ndërmarrjeje. Së fundmi, ankuesi ishte kontaktuar më 6 shtator 2021, i cili kishte thënë se punonjësit e N.Sh. "Liria" ende nuk ishin kompensuar për pronat e shpronësuara.
14. Për më shumë, ankuesi kishte paraqitur te Avokati i Popullit kërkesën e tij të datës 2 nëntor 2020, drejtuar kryeministrit të Republikës së Kosovës, për kompensimin e mjeteve që u takonin me ligj nga shpronësimi i N.Sh. "Liria". Ankuesi po ashtu kishte paraqitur një përgjigje nga Departamenti i Shpronësimit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, e datës 15 dhjetor 2020, ku thuhej se për sa i përket pagesës për pronat ish-shoqërore, në mungesë të buxhetit dhe për shkak se AKP-ja është institucion i Republikës së Kosovës, Departamenti i Shpronësimit nuk kishte bërë pagesa për ish-pronat shoqërore, të cilat ishin shpronësuar për interes nacional.
15. Më 13 dhjetor 2021, Avokati i Popullit i ishte drejtuar me shkresë kryeministrit të Republikës së Kosovës, me një përshkrim të rastit dhe me vlerësimin se ishte e pakontestueshme se një numër pronash të N.Sh. "Liria", që ishin përfshirë në shpronësimin e kryer nga ana e Qeverisë, për ndërtimin e autostradës Vërmicë – Merdare, dhe duke u bazuar në përgjigjen e datës 15 dhjetor 2020 nga Departamenti i Shpronësimit i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, ish-punonjësit e N.Sh. "Liria" nuk ishin kompensuar për pronat e shpronësuara sipas Vendimit përfundimtar 12/133, datë 5 qershor 2013. Mbetet e paqartë nëse ishte bërë ndonjë kompensim për shpronësimin e pronave të N.Sh. "Liria" në bazë të vendimeve të tjera për shpronësim, për shkak të përgjigjeve kundërthënëse në mes të Departamentit për Shpronësim dhe AKP-së, edhe për shkak të kundërthënies nga vetë Departamenti i Shpronësimit, ku në përgjigjen për Avokatin e Popullit, e datës 8 gusht 2018, thuhej se pronat e N.Sh. "Liria", të zonës kadastrorë Bardhosh, ishin kompensuar sipas Vendimit përfundimtar Nr.03/100, datë 12 nëntor 2014, ndërsa në përgjigjen për ankuesin, datë 15 dhjetor 2020, thuhej se Departamenti i Shpronësimit nuk kishte bërë pagesa për ish-pronat shoqërore, të cilat ishin shpronësuar për interes nacional. Për më tepër, Avokati i Popullit konsideron se çështja e ngritur nga ankuesi kërkon vëmendjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe të autoriteteve përkatëse, në mënyrë që sa më parë të jetë e mundur, të bëhet kompensimi i pasurisë së shpronësuar i kësaj ndërmarrjeje, në pajtim me Vendimin përfundimtar Nr.12/133, i datës 5 qershor 2013.
16. Më 14 janar 2022, Avokati i Popullit kishte marrë një përgjigje nga Zyra për Qeverisje të Mirë, ku mes të tjerash thuhej se Departamenti i Shpronësimit, në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm, prioritet u kishte dhënë pronave private, ndërsa pronat shoqërore nuk i kishte kompensuar, bazuar edhe në faktin se Agjencia Kosovare e Privatizimit kishte mjete të mjaftueshme për pagesën e 20% të punëtorëve të ish-ndërmarrjeve shoqërore.

17. Avokati i Popullit, gjatë komunikimit me ankuesin, kishte kuptuar që ai dhe një grup ish-punonjësish të N.Sh. "Liria", më 27 prill 2022 kishin paraqitur padi në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, për kompensimin e shumës prej 20% të të hyrave nga shpronësimi i një pjese të tokës së ish-N.Sh. "Liria", me vendimet përfundimtare të Qeverisë së Republikës së Kosovës: nr.03/100, datë 12 nëntor 2012, dhe nr.12/133, datë 14 qershor 2013, padi kjo që sipas ankuesit ende nuk ka filluar të shqyrtohet nga Dhoma e Posaçme.
18. Avokati i Popullit, po ashtu gjatë komunikimit që kishte pasur me ankuesin, gjatë muajit maj 2023, kishte mësuar se çështja e kompensimit të vlerës 20% nga shpronësimi i pronave të N.Sh. "Liria" ende nuk ishte realizuar.

IV. KONSTATIMET E AVOKATIT TË POPULLIT

19. Ligji nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, neni 44, paragrafi, pika (3) përcakton: *"Nëse prona është hequr nga administrimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, shumata e kompensimit do t'i paguhet AKP-së. AKP e mban shumën e kompensimit në mirëbesim me qëllim të përmbushjes së të drejtave të punëtorëve si dhe kërkesave të pronarëve dhe kreditorëve lidhur me pronën përkatëse. Shpërndarja e këtij kompensimit, duke përfshirë sipas rastit kthimin e suficitit në Qeveri do të bëhet në përputhje me të njëjtat ligje dhe rregullat që zbatohen për shpërndarjen e fondeve të tjera që mbahen në mirëbesim nga AKP."*
20. Avokati i Popullit vëren se Ligji Nr. 06/L -023 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 05/l-080, neni 6/A [Kompensimi për pronat e shpronësuara të Ndërmarrjeve Shoqërore], përcakton:
- "1. Pavarësisht nga neni 11 paragrafi 8 si dhe neni 26 paragrafi 1 i Ligjit nr.03/L-205 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, Qeveria e Kosovës brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike merr për obligim që lidhur me shpronësimet e pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore nga vlera e përgjithshme e shpronësimit, t'i kompensoj Agjencisë shumata si në vijim: 1.1. Njezet përqind (20%) e vlerës së pronës së shpronësuar, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjeve Shoqërore në pajtim me nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 mbi transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore, të ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/45."*
21. Ndërsa po i njëjti ligj, në nenin 5 të tij, përcakton:
- "Ky nen vlen për shpronësimet e pronave të Ndërmarrjeve Shoqërore që kanë filluar dhe janë në procedurë të kompensimit dhe për pronat e Ndërmarrjeve Shoqërore në të ardhmen."*
22. Ky ligj ishte shpallur në Gazetën Zyrtare më 3 maj 2018 dhe kishte hyrë në fuqi dy javë pas shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare. Ndërsa në një përgjigje që Avokati i Popullit kishte pranuar nga AKP-ja, më 8 tetor 2018, ishte sqaruar se N.Sh. "Liria" i ishte nënshtruar procesit të likuidimit, i cili zyrtarisht kishte filluar nga data 11.6.2013 dhe se ky proces ishte në vijim e sipër.

23. Ligji 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në nenin 1.17 përcakton se pronar është *“personi ose subjekti i cili ka një pretendim të vlefshëm në një të drejtë ose interes pronësor në një ndërmarrje apo ndaj saj”*.
24. Avokati i Popullit, nga komunikimet me AKP-në, kishte vërejtur se ankuesi është punëtor i kualifikuar i KB “Liria” në Bardhosh, është përfshirë në listë të fondeve prej 20% nga privatizimi i aseteve të ndërmarrjes.
25. E drejta e pronës në Republikën e Kosovës është e garantuar me Kushtetutë. Neni 46, paragrafi 3, i Kushtetutës përcakton: *“Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.”*
26. Prona e ndërmarrjes i ishte nënshtruar procesit të shpronësimit në vitin 2013 dhe as pas 10 vjetësh ankuesi nuk ka arritur ta merrte kompensimin për pronën e shpronësuar, megjithëse me Kushtetutë kërkohet *“sigurimi i kompensimit të menjëhershëm”*.
27. E drejta e pronës është e garantuar edhe me instrumentet ndërkombëtare drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Neni 22 i Kushtetutës parasheh një numër konventash dhe instrumentesh ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.
28. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, në nenin 17 parasheh:
- “1. Secili k të drejtë të ketë pasuri, vetë dhe në bashkësi me të tjerët. 2. Askush nuk duhet të privohet arbitrarisht nga pasuria e tij.”*
29. Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Protokollin 1, neni 1 [Mbrojtja e Pronës], parasheh:
- “Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.*
- Megjithatë, dispozitat e mëparshme nuk cenojnë të drejtën e Shteteve për të zbatuar ligje, që ato i çmojnë të nevojshme për të rregulluar përdorimin e pasurive në përputhje me interesin e përgjithshëm ose për të siguruar pagimin e taksave ose të kontributeve ose të gjobave të tjera.”*
30. Kushtetuta në nenin 53 përcakton: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
31. Në jurisprudencën e GjEDNj-së ka shumë raste ku kjo gjykatë ka konstatuar shkelje të Protokollit 1, neni 1, kur kanë ndërhyrë në të drejtat pronësore në mënyrë arbitrare, për shkak të ndërhyrjeve joproporcionale, ose për shkak të kompensimit joadekuat.¹

¹ Shih mes të tjerash rastet e GjEDNj-së: *Belgan Linguistic kundër Belgjikës*, aktgjykimi i 23 korrikut 1968; *Sporrong dhe Lönnroth kundër Suedisë*, vendimi i 23 shtatorit 1982; *James kundër Mbretërisë së Bashkuar*, aktgjykimi i 21 shkurtit 1986. *Marckx kundër Belgjikës*, aktgjykimi i 13 qershorit 1979. *Loizidou kundër Turqisë*,

32. Për më tepër, për Avokatin e Popullit mbetet i papranueshëm qëndrimi nga përgjigjja e fundit e ZQM/ZKM, i datës 14 janar 2022, ku thuhej se Departamenti i Shpronësimit, në mungesë të buxhetit të mjaftueshëm, prioritet u kishte dhënë pronave private, ndërsa pronat shoqërore nuk i kishte kompensuar, bazuar edhe në faktin se Agjencia Kosovare e Privatizimit kishte mjete të mjaftueshme për pagesën e 20% të punëtorëve të ish-ndërmarrjeve shoqërore. Ligji nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në nenin 2, paragrafi 1, përkufizon: *“Organi Shpronësues” nënkupton një Komunë ose Qeverinë që është e autorizuar për kryerjen e shpronësimit sipas nenit 4 të këtij ligji.* Pra AKP-ja nuk mund të jetë organ shpronësues në asnjë rrethanë, sikurse nuk është edhe në rastin konkret.
33. Avokati i Popullit vlerëson se, megjithëse ankuesi kishte paraqitur ankesë kundër AKP-së, si palë përgjegjëse, Avokati i Popullit gjatë hetimit të rastit ka ardhur në përfundim se palë përgjegjëse në rastin konkret është Qeveria e Republikës së Kosovës.
34. Avokati i Popullit e ka parasysh faktin se ankuesi kishte ngritur padinë në Dhomën e Posaçme dhe se në rrethana të tilla Avokati i Popullit, në pajtim me Ligjin Nr.05/L-19 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 8, nuk do të kishte kompetencë për trajtimin e çështjes, përveç në rast të zvarritjes së rastit nga gjykata. Mirëpo ankuesi e kishte ngritur çështjen te Avokati i Popullit para se t’i drejtohej gjykatës dhe se padia në gjykatë ishte paraqitur kundër AKP-së, që në rastin konkret duket se nuk është palë përgjegjëse lidhur me kompensimin për pronat e shpronësuara të N.Sh. “Liria”. Sidoqoftë, Avokati i Popullit ia përcjellë këtë raport edhe Dhomës së Posaçme që informatat nga ky raport t’i ketë parasysh gjatë trajtimit të padisë së paraqitur nga ankuesi.
35. Avokati i Popullit konstaton se ankuesit si dhe pronarëve të tjerë, të cilëve nuk u është kompensuar vlera 20% nga shpronësimi i pronave të N.SH “Liria”, u është shkelur e drejta e pronës e garantuar me Kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare, drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Prandaj i Avokati i Popullit i

REKOMANDON

- **Qeverisë së Republikës së Kosovës, që pa vonesa të mëtutjeshme, t’i transferojë mjetet për kompensimin e pronës së shpronësuar të N.SH. “Liria” Bardhosh, tek Agjencia Kosovare e Privatizimit, në mënyrë që punëtorëve të kualifikuar të ndërmarrjes t’u bëhet shpërndarja e vlerës prej 20% të pronave të shpronësuar.**

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”*) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për*

aktgjykimi i datës 18 dhjetor 1996; *Papamichaldopoulos kundër Greqisë*, janar 1993; *Jahn kundër Gjermanisë*, aktgjykimi i 22 janarit 2004.

veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit

